



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 86 , Datë 12.05.2020

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SOLARIS POWER” SH.P.K. PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 13, pika 2, gërma “a”, dhe pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.109, datë 29.06.2016 e ndryshuar, dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”) të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.05.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e “Drejtorisë së Licensimit, Mbikëqyrjes dhe Autorizimeve”, lidhur me “refuzimin e kërkesës së Shoqërisë Solaris Power”sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 48, datë 24.03.2020, ka vendosur:“Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Solaris Power sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, në datën 25.03.2020 është bërë njoftimi në media (online), dhe pas përfundimit të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve në lidhje me këtë aplikim, në zbatim të nenit 10, pika 11, të rregullores së sipërcituar, nuk ka rezultuar të ketë pasur objeksione apo komente nga palët e interesit.
- Pas fillimit të procedurës, shoqërisë i është dërguar në datën 31.03.2020 shkresa me e-mail për njoftimin e vendimit dhe kërkesa për depozitimin e dokumentacionit të munguar apo informacionit shtesë.
- Shoqëria Solaris Power sh.p.k, nuk ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.

- Aplikimi i Shoqërisë Solaris Power sh.p.k., nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) në Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

neni 9, pika 1:

- gërma “a” (të dhënat për aplikimin) është **plotësuar pjesërisht**
- gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) është **plotësuar pjesërisht**
- gërma “c” (të dhëna për aplikuesin) është **plotësuar pjesërisht**

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor

neni 9, pika 2

- gërma “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata), është **plotësuar pjesërisht**.
- gërma “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse) është e **pa plotësuar**.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal

neni 9, pika 3:

- gërma “c” (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, etj.) është e **pa plotësuar**.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike

neni 9, pika 4.8

- gërma “a” (Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh sipas viteve) është e **pa plotësuar**
- gërma “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj) është e **pa plotësuar**.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të refuzojë kërkesën e Shoqërisë Solaris Power sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI